

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr.10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Mjedisit
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Finale
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	I brendshëm
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Jo e zbatueshme
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	Nuk ka publikime apo strategji të lidhura me të
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	15.04.2026 - 15.05.2026
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	21/07/2026
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	Po, 18/06/2026
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2026 - MM
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Ilda Shahu e-mail-i: ilda.shahu@mjedisi.gov.al numri i telefonit: 0692964531
PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (Maksimumi 2 faqe)	
PERKUFIZIMI I PROBLEMIT Problemi kryesor që synon të adresojë projektligji lidhet me mangësitë e kuadrit aktual ligjor dhe institucional për mbështetjen financiare, koordinimin dhe zbatimin e politikave mjedisore në Republikën e Shqipërisë. Gjatë zbatimit të ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar, janë evidentuar disa boshllëqe rregullatore dhe institucionale që kufizojnë efektivitetin e ndërhyrjeve në fushën e mjedisit. Në veçanti, kuadri aktual nuk parashikon një mekanizëm të dedikuar dhe të qëndrueshëm financiar për mbështetjen e projekteve dhe masave mjedisore, duke sjellë fragmentim të burimeve financiare dhe vështirësi në planifikimin afatgjatë të investimeve në këtë sektor. Gjithashtu, ndryshimet institucionale të ndërmarra në kuadër të reformës së inspektimeve nuk janë reflektuar plotësisht në ligjin nr. 10431, çka ka sjellë paqartësi në ndarjen e kompetencave ndërmjet institucioneve përgjegjëse për monitorimin, kontrollin dhe zbatimin e legjislacionit mjedisor. Një problem tjetër lidhet me mungesën e bazës ligjore për instrumente të reja të politikave mjedisore dhe klimatike, veçanërisht në fushën e restaurimit të natyrës dhe certifikimit të largimit të karbonit, duke kufizuar mundësinë për zbatimin e masave moderne që kontribuojnë në mbrojtjen e biodiversitetit, rikuperimin e ekosistemeve dhe përbushjen e objektivave klimatike. Këto mangësi kanë ndikuar në efektivitetin e politikave mjedisore, në koordinimin ndërinstitucional, në mobilizimin e financimeve kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe në	

aftësinë e institucioneve për të adresuar në mënyrë të qëndrueshme sfidat që lidhen me mbrojtjen e mjedisit dhe ndryshimet klimatike.

.

Këto mangësi kanë sjellë fragmentim të financimit të projekteve mjedisore, kufizime në mobilizimin e fondeve kombëtare dhe ndërkombëtare, vështirësi në koordinimin ndërinstitutional dhe pengesa në zbatimin e instrumenteve moderne të politikave mjedisore.

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe rezultatet e synuara të propozimit? (jo më shumë se 7 rreshta)

Objektivi i ndërhyrjes ligjore është përmirësimi i kuadrit ligjor dhe institucional në fushën e mbrojtjes së mjedisit, nëpërmjet forcimit të mekanizmave financiarë, përmirësimit të koordinimit institucional dhe krijimit të instrumenteve të reja për mbështetjen e politikave mjedisore dhe klimatike.

Objektivat specifikë që synohen të arrihen:

Të krijohet Fondi Kombëtar i Mjedisit brenda vitit 2027 si mekanizëm i qëndrueshëm për financimin e projekteve mjedisore.

Ulja rasteve të mbivendosjeve dhe konflikteve të kompetencave ndërmjet institucioneve përgjegjëse nëpërmjetqartësimit të kompetencave të institucioneve ndërmjet institucioneve përgjegjëse brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit.

Të mundësohet, deri në vitin 2028, krijimi i bazës ligjore për zbatimin e instrumenteve të reja të politikës klimatike, përfshirë certifikimin e largimit të karbonit, në përputhje me acquis të Bashkimit Evropian.

Rritja me 30% e numrit të projekteve mjedisore të financuara përmes Fondit Kombëtar të Mjedisit gjatë tre viteve të para, krahasuar me nivelin bazë të financimit publik para krijimit të fondit.

Rritja deri në 200,000,000 lekë të financimeve për projektet mjedisore brenda pesë viteve nga funksionimi i fondit.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. (jo më shumë se 7 rreshta)

Për arritjen e objektivave të politikës janë shqyrtuar opsionet e mëposhtme:

Opsioni 0 (status quo): -ja

Sipas këtij opsioni nuk ndërhyhet me ndryshim apo politikë të re dhe vijohet me kuadrin ligjor ekzistues dhe për rrjedhojë nuk ndërmerret asnjë masë për të shmangur problematikat që janë evidentuar deri më tani. Në këtë rast, financimi i projekteve mjedisore do të

vazhdonte të realizohej përmes mekanizmave ekzistues, të cilët karakterizohen nga fragmentim dhe mungesë koordinimi.

Ky opsion ka avantazhin që nuk kërkon kosto shtesë administrative apo ndryshime institucionale në afat të shkurtër. Megjithatë, ky përfitim është i kufizuar, pasi nuk adreson asnjë nga shkaqet kryesore të problemit. Konkretisht, do të vazhdonte mungesa e një fondi të dedikuar, do të ruhej shpërndarja jo e strukturuar e burimeve financiare dhe nuk do të përmirësohej koordinimi ndërinstitutional.

Si rezultat, efekti i politikave mjedisore do të mbetet i kufizuar dhe nuk do të krijoheshin kushtet për financimin e qëndrueshëm të projekteve me impakt të lartë. Për rrjedhojë, ky opsion nuk konsiderohet i pranueshëm, pasi nuk mundëson arritjen e objektivave të vendosura.

Opsioni 1 (jo rregullator) Vetërregullimi dhe gjetja e zgjidhjeve përmes mekanizmave jorregullatore të problemeve të konstatuara si ndërgjegjësimi publik, trajnime, apo iniciativa vullnetare nga institucionet dhe aktorët e përfshirë.

Ky opsion paraqet një fleksibilitet më të madh dhe kërkon kosto më të ulëta fillestare, duke mos imponuar ndryshime në kuadrin ligjor. Megjithatë, nga analiza rezulton se problemet e identifikuar nuk janë të natyrës që mund të zgjidhen përmes ndërhyrjeve të tilla.

Në mënyrë të veçantë, mungesa e një mekanizmi financiar të dedikuar dhe e një sistemi të strukturuar vendimmarrjeje nuk mund të kompensohet me masa vullnetare. Po ashtu, ky opsion nuk adreson paqartësitë institucionale dhe nuk krijon detyrime të qarta për institucionet përgjegjëse. Për rrjedhojë, ndikimi i këtij opsioni vlerësohet si i kufizuar dhe jo i qëndrueshëm në kohë.

Opsioni 2: (Hartimi i një ligji të ri). Ky opsion është një opsion jo i preferuar, pasi në praktikë, hartimi i një ligji të ri do të kërkonte kohë më të gjatë për përgatitje, konsultime dhe miratim, si dhe burime më të mëdha administrative. Ndërkohë, ndërhyrjet e propozuara janë të fokusuara dhe nuk prekin në mënyrë të gjerë strukturën e ligjit në fuqi.

Në këto kushte, ky opsion konsiderohet joefikas dhe jo i përshtatshëm në raport me urgjencën dhe përmasën e problemit.

Opsioni 3: I preferuar. Ndryshimi i ligjit ekzistues “Për mbrojtjen e mjedisit” i ndryshuar është vlerësuar si më i përshtatshmi, parashikon ndërhyrje të targetuar në ligjin ekzistues përmes disa ndryshimeve dhe shtesave konkrete.

Nëpërmjet këtij opsioni synohet:

- krijimi i Fondit Kombëtar të Mjedisit, si mekanizëm i qëndrueshëm financiar;
- përcaktimi i rregullave të qarta për financimin, përzgjedhjen dhe monitorimin e projekteve;
- qartësimi i rolit të Ministrisë dhe eliminimi i mbivendosjeve institucionale;
- përfshirja e instrumenteve të reja të politikave mjedisore, si restaurimi i natyrës dhe certifikimi i karbonit.

Ky opsion paraqet disa avantazhe të rëndësishme.

Së pari, ai adreson drejtpërdrejt shkaqet e problemit pa pasur nevojë për një rishikim të plotë të kuadrit ligjor.

Së dyti, ka kosto më të ulët dhe mund të zbatohet në një afat më të shkurtër. Së treti, krijon një strukturë më të qartë dhe të administrueshme për financimin e projekteve mjedisore.

Nga ana tjetër, ky opsion kërkon miratimin e akteve nënligjore për zbatimin e tij dhe një shkallë të caktuar koordinimi ndërinstitutional. Megjithatë, këto kërkesa konsiderohen të menaxhueshme dhe proporcionale me përfitimet që sjell.

Për këto arsye, opsioni i ndryshimit të ligjit ekzistues vlerësohet si alternativa më e përshtatshme për arritjen e objektivave të politikës.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përshkruajë ndikimet në mënyrë sasiore (monetare) dhe cilësore (narrative) mbi buxhetin dhe grupet e tjera të prekura. (jo më shumë se 7 rreshta)

Ndikimet kryesore të opsionit të preferuar janë:

Ndikimet ekonomike, (pozitiv, i lartë afatgjatë): Në planin ekonomik, krijimi i Fondit Kombëtar të Mjedisit pritet të përmirësojë ndjeshëm mënyrën e financimit të projekteve mjedisore. Në vend të një shpërndarjeje të fragmentuar të burimeve, fondi krijon një mekanizëm të centralizuar dhe më efikas.

Në afat të mesëm dhe të gjatë, kjo pritet të nxisë investimet në sektorin e mjedisit, si nga sektori publik ashtu edhe nga ai privat. Gjithashtu, një kuadër i qartë financiar rrit mundësitë për përthithjen e fondeve ndërkombëtare.

Ndikim mjedisor, (pozitiv, i lartë): Ndikimet më të rëndësishme priten në përmirësimin e treguesve mjedisorë. Rritja e financimit dhe orientimi i tij drejt projekteve prioritare do të mundësojë ndërhyrje më të qëndrueshme në drejtim të reduktimit të ndotjes dhe mbrojtjes së biodiversitetit.

Përfshirja e instrumenteve të rinj, si restaurimi i natyrës dhe mekanizmat për largimin e karbonit, krijon gjithashtu mundësi për të zbatuar politika më moderne dhe më të përafuara me praktikatat evropiane.

Ndikim social (pozitiv, i mesëm): Ky opsion pritet të rrisë aksesin në financim për aktorë të ndryshëm, përfshirë organizatat jofitimprurëse, bizneset dhe individët. Kjo rrit përfshirjen e shoqërisë në mbrojtjen e mjedisit dhe kontribuon në përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve.

Grupet e prekura: Ministria e Mjedisit (autoritet menaxhues i fondit përmes nenit 58/1); AKM, personat fizikë dhe juridikë (aplikantë potencialë); agjencitë e varësisë (propozues projektsh); publiku i gjerë (përfitues mjedisor).

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.

Është zgjedhur **Opsioni 3**, që konsiston në ndryshimin e ligjit ekzistues nr.10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar, pasi ai adreson në mënyrë të drejtpërdrejtë problematikat e identifikuara dhe ofron raportin më të favorshëm ndërmjet kostove dhe përfitimeve.

Ky opsion mundëson krijimin e Fondit Kombëtar të Mjedisit si mekanizëm i dedikuar financiar për mbështetjen e projekteve dhe programeve mjedisore, duke siguruar financim më të strukturuar, më transparent dhe më të qëndrueshëm për zbatimin e politikave mjedisore dhe klimatike.

Gjithashtu, ai siguron harmonizimin e ligjit me reformën e inspektimeve, përmes qartësimit të kompetencave dhe përgjegjësi të institucioneve përgjegjëse për monitorimin, kontrollin dhe zbatimin e legjislacionit mjedisor, duke reduktuar mbivendosjet institucionale dhe duke përmirësuar koordinimin ndërinstitucional.

Ndërhyrja krijon gjithashtu bazën ligjore për restaurimin e natyrës dhe për certifikimin e largimit të karbonit, duke përfshirë instrumente të reja që mbështesin mbrojtjen e biodiversitetit, rikuperimin e ekosistemeve dhe arritjen e objektivave klimatike.

Nga analiza e opsioneve të shqyrtuara rezulton se ky opsion është më proporcional dhe më efikas se alternativat e tjera, pasi arrin objektivat e politikës pa pasur nevojë për rishikimin e plotë të kuadrit ligjor ekzistues. Sa i përket analizës së kostove dhe përfitimeve, për shkak të natyrës së ndërhyrjes dhe mungesës së të dhënave të plota financiare, nuk është e mundur të bëhet një kuantifikim i plotë monetar në këtë fazë.

Megjithatë, vlerësohet se kostot buxhetore janë të kontrolluara dhe varen nga fondet e miratuara çdo vit dhe përfitimet afatgjata, në terma mjedisorë, ekonomikë dhe socialë, janë të konsiderueshme dhe tejkalojnë kostot fillestare.

Nga pikëpamja e ndikimeve, zbatimi i këtij opsioni pritet të sjellë përfitime të rëndësishme:

- rritje të kapacitetit financiar të ministrisë për mbështetjen e projekteve mjedisore;
- mobilizim të burimeve shtesë financiare, përfshirë financime ndërkombëtare;
- përmirësim të efektivitetit të politikave mjedisore në nivel kombëtar.

Ndikimet negative të mundshme, si nevoja për riorganizim administrativ dhe miratimi i akteve nënligjore, konsiderohen të kufizuara dhe të menaxhueshme, dhe nuk cenojnë efektet pozitive të përgjithshme të ndërhyrjes.

Në vijim të analizës me shumë kriterë (Multi-Criteria Analysis), e cila merr në konsideratë faktorë si efektiviteti, kosto-efektiviteti, përputhshmëria me politikat kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe ndikimi në përmirësimin e treguesve mjedisorë, ky opsion është vlerësuar si alternativa më e favorshme. Rezultatet e kësaj analize tregojnë se opsioni 3 arrin nivelet më të larta të performancës në raport me opsionet e tjera, veçanërisht për sa i përket:

- rritjes së eficiencës në përdorimin e burimeve publike;
- forcimit të mekanizmave të mbrojtjes së mjedisit;
- nxitjes së pjesëmarrjes së aktorëve të ndryshëm në financimin dhe zbatimin e projekteve.

Nga pikëpamja e teknikës legjislative, ndërhyrja konsiderohet e përshtatshme dhe proporcionale, pasi ndryshimet nuk prekin në mënyrë të gjerë strukturën e ligjit në fuqi dhe nuk tejkalojnë prapenjë të zakonshme të ndërhyrjes (nën 50% të dispozitave). Kjo e bën opsionin më të lehtë për t'u zbatuar dhe më pak të ekspozuar ndaj pasigurive juridike.

Në këtë kuadër, përdorimi i analizës me shumë kriterë është konsideruar metoda më e përshtatshme për vlerësimin e opsioneve, duke ofruar një pasqyrë më të plotë të ndikimeve.

Në përfundim, opsioni i ndërhyrjes në ligjin ekzistues përmes krijimit të një mekanizmi financiar të qëndrueshëm, qartësimi të roleve institucionale dhe integritetit të instrumenteve të reja të politikave mjedisore, paraqet zgjidhjen më efikase dhe të qëndrueshme për arritjen e objektivave të përcaktuara dhe për përmirësimin e përgjithshëm të sistemit të mbrojtjes së mjedisit.

Kostoja e përlogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):

Viti 1	Viti 2	Viti 3
100,000,000 leke (burimet caktohen vjetore me ligj buxheti)	100,000,000 leke	100,000,000 leke

KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar? (jo më shumë se 5 rreshta - të plotësohet nëse është kryer konsultimi publik)

Në kuadër të procesit të konsultimit publik, projektligji është publikuar në datën 15.04.2026 dhe periudha e konsultimit është mbyllur në datën 15.05.2026. Gjatë kësaj periudhe janë regjistruar 623 shikime dhe janë paraqitur gjithsej 5 komente.

Komentet e paraqitura janë fokusuar kryesisht në:

- nevojën për integrimin e sistemeve digjitale dhe fiskale në monitorimin e proceseve mjedisore;
- propozime për organizimin institucional dhe modelin e administrimit të fondeve dhe sistemeve;
- rritjen e transparencës dhe gjurmueshmërisë së flukseve financiare dhe të mbetjeve përmes platformave të integruara;
- përmirësimin e mekanizmave të raportimit dhe monitorimit në mbështetje të zbatimit të politikave mjedisore.

Komentet e marra u shqyrtuan nga strukturat përgjegjëse të ministrisë. Një pjesë e sugjerimeve që lidhen me transparencën, monitorimin dhe raportimin e projekteve do të merren në konsideratë gjatë hartimit të akteve nënligjore në zbatim të ligjit. Ndërsa propozimet që lidhen me krijimin e strukturave të reja institucionale apo modele alternative të administrimit të fondit nuk u reflektuan në projektligj, pasi tejkalojnë objektin dhe qëllimin e kësaj nisme ligjore, e cila synon krijimin e një mekanizmi financiar brenda kuadrit ekzistues institucional.

Në përfundim, komentet e paraqitura nuk kanë sjellë nevojën për ndryshime në objektivat, parimet apo strukturën e projektligjit, por kanë kontribuar në qartësimin e aspekteve që do të adresohen në fazën e zbatimit dhe në aktet nënligjore përkatëse.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?

Zbatimi i këtij projektligji të propozuar do të realizohet nëpërmjet një strukture të organizuar institucionale, e cila garanton ndarjen e qartë të përgjegjësisë dhe funksionimin e koordinuar të proceseve të financimit dhe mbikëqyrjes së projekteve mjedisore.

Rolin kryesor në zbatimin e ligjit e ka **ministra përgjegjëse për mjedisin**, e cila vepron si autoriteti qendror për administrimin e Fondit Kombëtar të Mjedisit. Ministria është përgjegjëse për zbatimin e përgjithshëm të ligjit; drejtimin dhe koordinimin e politikave mjedisore; administrimin e Fondit Kombëtar të Mjedisit; zhvillimin dhe zbatimin e instrumenteve të rinj, si restaurimi i natyrës dhe certifikimi i largimit të karbonit, si dhe për mbikëqyrjen e të gjithë ciklit të financimit – nga aplikimi deri te përfundimi i projekteve.

Në nivel rregullator, **Këshilli i Ministrave** ka një rol kyç përmes miratimit të akteve nënligjore përkatëse (VKM), të cilat do të përcaktojnë në mënyrë të detajuar rregullat e funksionimit të fondit, kriteret dhe procedurat për certifikimin e largimit të karbonit, masat për restaurimin e natyrës, rregullat e përgjithshme të financimit dhe përzgjedhjes së projekteve. Këto akte do të sigurojnë një bazë të qartë dhe të unifikuar për zbatimin e ligjit.

Një element i rëndësishëm i strukturës së zbatimit është **kolegjiumi**, si organ teknik këshillimor. Ky organ, i përbërë nga nëpunës të nivelit të lartë dhe të mesëm të administratës publike, ka përgjegjësinë për shqyrtimin, vlerësimin dhe klasifikimin e projekteve në bazë të kriterëve të përcaktuara. Në këtë mënyrë sigurohet që procesi i përzgjedhjes të jetë transparent, profesional dhe i bazuar në merita.

Vendimmarrja përfundimtare për miratimin e projekteve i takon **ministrit përgjegjës për mjedisin**, i cili merr vendim mbi bazën e propozimeve të kolegjiumit.

Monitorimi i zbatimit

Monitorimi i zbatimit të ligjit do të realizohet nëpërmjet:

Raportimit periodik nga ministria, i cili do të përfshijë:

- ecurinë e zbatimit të ligjit në tërësi;
- funksionimin e Fondit Kombëtar të Mjedisit;
- zbatimin e instrumenteve të rinj (restaurimi i natyrës, certifikimi i karbonit);
- progresin në harmonizimin institucional dhe eliminimin e mbivendosjeve.

Ndjekjes së treguesve të performancës, të cilët nuk lidhen vetëm me projektet, por edhe me:

- nivelin e zbatimit të akteve nënligjore;
- funksionimin efektiv të strukturave përgjegjëse;
- përmirësimin e koordinimit ndërinstitutional;
- ndikimin e politikave në treguesit mjedisorë.

Kontrollit dhe auditimit financiar dhe administrativ, në përputhje me legjislacionin për financat publike dhe sistemet e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm. Ky kontroll garanton ligjshmërinë, transparencën dhe eficiencën në përdorimin e burimeve.

Vlerësimi të përgjithshëm të ndikimit të ligjit, duke analizuar nëse ndërhyrjet e propozuara kanë sjellë përmirësime në:

- cilësinë e mjedisit;
- zbatimin e politikave mjedisore;
- përmbushjen e detyrimeve ndaj Bashkimit Evropian.

Ky sistem zbatimi dhe monitorimi siguron një qasje të plotë dhe të integruar, që nuk kufizohet vetëm në administrimin e fondeve, por mbulon të gjithë ciklin e politikës mjedisore: nga hartimi i rregullave dhe koordinimi institucional, deri te zbatimi në praktikë dhe vlerësimi i rezultateve.

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

- *Jepni kontekstin e politikës*

Ligji nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar, është ligji bazë fushën e mjedisit, i cili përcakton parimet bazë, institucionet dhe instrumentet kryesore për mbrojtjen dhe menaxhimin e mjedisit.

Ky ligj është përafuar me Direktivën 2004/35/KE të Bashkimit Evropian mbi përgjegjësinë mjedisore për parandalimin dhe riparimin e dëmeve në mjedis, duke vendosur bazat për një sistem modern të mbrojtjes së mjedisit.

Që prej miratimit të tij, ligji ka pësuar disa ndryshime dhe plotësime të rëndësishme, konkretisht:

Ligji nr.31/2013, datë 14.2.2013, synoi përmirësimin e kuadrit institucional dhe procedural në fushën e mbrojtjes së mjedisit, si dhe forcimin e mekanizmave për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i përafrimit me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Ligji nr.53/2020, datë 30.4.2020, u miratua me qëllim modernizimin e mëtejshëm të kuadrit rregullator mjedisor, forcimin e instrumenteve administrative dhe harmonizimin e dispozitave të ligjit me zhvillimet e reja të legjislacionit kombëtar dhe evropian.

Ligji nr.66/2024, datë 4.7.2024, synoi adresimin e nevojave të evidentuara gjatë zbatimit praktik të ligjit, si dhe përmirësimin e funksionimit të instrumenteve ekzistuese të mbrojtjes dhe menaxhimit të mjedisit.

Ligji nr.99/2024, datë 12.9.2024, u miratua në funksion të harmonizimit të dispozitave të ligjit për mbrojtjen e mjedisit me reformën e inspektimeve dhe riorganizimin institucional në këtë fushë, me qëllim qartësimin e kompetencave të institucioneve përgjegjëse dhe shmangien e mbivendosjeve institucionale.

Ndër aktet më të rëndësishme nënligjore të dala në zbatim të ligjit janë:

VKM-të që rregullojnë procedurat e Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM) dhe Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM), të cilat përcaktojnë procedurat për shqyrtimin dhe miratimin e planeve, programeve dhe projekteve që mund të kenë ndikim në mjedis;

VKM-të që rregullojnë sistemin e lejeve mjedisore, kushtet, kriteret dhe procedurat për pajisjen me leje mjedisore të veprimtarive ekonomike;

VKM-të që përcaktojnë rregullat për monitorimin e gjendjes së mjedisit dhe raportimin e treguesve mjedisorë në nivel kombëtar;

VKM-të që garantojnë aksesin e publikut në informacionin mjedisor dhe pjesëmarrjen e publikut në proceset vendimmarrëse mbi çështjet mjedisore. Ndërkohë jemi në proces të rishikimit të kësaj VKM-je me synim të harmonizimit të plotë me direktivën përkatëse dhe Konventën e Aarhusit për të drejtën e publikut në vendimarrje mjedisore;

Draft VKM-të që rregullojnë procedurat për parandalimin dhe riparimin e dëmeve në mjedis, në zbatim të parimit “ndotësi paguan” janë në proces finalizimi dhe konsultimi, të cilat synojnë transpozimin dhe harmonizimin e plotë me direktivat respektive të BE-së.

VKM-të që lidhen me organizimin dhe funksionimin e institucioneve përgjegjëse në fushën e mjedisit, si dhe koordinimin ndërinstitutional në hartimin dhe zbatimin e politikave mjedisore,

kryesisht për AKM apo funksionet e inspektimit të strukturave inspektuese në fushën e mjedisit, në harmonizim edhe me ligjin e ri të inspektimeve në RSH; VKM që lidhet me sistemin e të dhënave mjedisore (SIM).

Megjithatë, këto ndryshime kanë qenë të orientuara kryesisht në përmirësime specifike dhe nuk kanë adresuar në mënyrë të plotë disa elemente strukturore të funksionimit të sistemit, veçanërisht në drejtim të mekanizmave financiarë për mbështetjen e politikave mjedisore, ndarjes së qartë të kompetencave institucionale dhe përfshirjes së instrumenteve të rinj të politikave mjedisore dhe klimatike.

Njëkohësisht, zhvillimi i kuadrit institucional në fusha të lidhura, si miratimi i legjislationit të ri për inspektimin (ligji nr. 99/2024), ka sjellë nevojën për harmonizimin e ligjit për mbrojtjen e mjedisit me ndarjen e re të funksioneve ndërmjet institucioneve, veçanërisht në lidhje me funksionin e inspektimit.

Në këtë kontekst, gjatë zbatimit të ligjit janë identifikuar disa nevoja konkrete për ndërhyrje, si:

- përfshirja e instrumenteve të rinj, si mekanizmat për njohjen dhe incentivimin e aktiviteteve që kontribuojnë në largimin e karbonit;
- forcimi i rolit të institucioneve përgjegjëse dhe qartësimi i kompetencave të tyre;
- krijimi i një baze ligjore për restaurimin e elementëve të natyrës;
- ndërtimi i një mekanizmi financiar të qëndrueshëm dhe të strukturuar për mbështetjen e politikave mjedisore.

Në këtë kontekst, ndërhyrja ligjore e propozuar synon të përditësojë dhe plotësojë kuadrin ekzistues ligjor, duke kaluar nga një sistem i fragmentuar drejt një qasjeje më të integruar dhe funksionale, në përputhje me zhvillimet më të fundit të politikave të Bashkimit Evropian dhe me nevojat e evidentuara gjatë zbatimit në praktikë.

Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Përshkruani natyrën e problemit.

Gjatë zbatimit të ligjit është evidentuar se një nga problematikat kryesore lidhet me mungesën e një mekanizmi financiar të qëndrueshëm dhe të dedikuar për mbështetjen e politikave dhe investimeve në fushën e mjedisit. Aktualisht, financimi i masave për mbrojtjen e mjedisit realizohet kryesisht nëpërmjet buxhetit të shtetit, programeve të donatorëve ose projekteve të veçanta, të cilat janë të fragmentuara, të përkohshme dhe nuk garantojnë vazhdimësi në zbatimin e prioritetëve kombëtare mjedisore.

Mungesa e një instrumenti të centralizuar financiar kufizon mundësinë për planifikimin afatgjatë të investimeve dhe për financimin e vazhdueshëm të masave që lidhen me rehabilitimin e zonave të ndotura, restaurimin e ekosistemeve, përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe ujit, ruajtjen e biodiversitetit, përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, si dhe mbështetjen e projekteve që kontribuojnë në tranzicionin drejt ekonomisë së gjelbër.

Në praktikë, kjo situatë sjell vonesa ose pamundësi në zbatimin e politikave mjedisore, pasi institucionet përgjegjëse varen nga fonde të rastësishme ose nga financime të jashtme, të cilat nuk janë gjithmonë të disponueshme dhe nuk mund të mbulojnë nevojat afatgjata të sektorit. Për më tepër, mungesa e një mekanizmi të dedikuar kufizon aftësinë e shtetit për të mobilizuar

burime financiare nga instrumentet ndërkombëtare dhe evropiane, të cilat shpesh kërkojnë ekzistencën e strukturave kombëtare të menaxhimit dhe bashkëfinancimit.

Në kushtet kur politikat e Bashkimit Evropian po i kushtojnë rëndësi gjithnjë e më të madhe financimit të veprimeve për klimën, restaurimin e natyrës dhe ekonominë qarkulluese, mungesa e një mekanizmi financiar të strukturuar përbën një pengesë për përmbushjen efektive të objektivave kombëtare dhe për përafrimin me acquis të Bashkimit Evropian. Për rrjedhojë, lind nevoja për krijimin e një baze ligjore që mundëson ngritjen dhe funksionimin e një mekanizmi të qëndrueshëm financiar, i cili të sigurojë burime të dedikuara, transparencë në administrimin e fondeve dhe mbështetje të vazhdueshme për zbatimin e politikave mjedisore.

Gjithashtu, pas reformës së inspektimeve dhe miratimit të ligjit nr.99/2024, funksionet e inspektimit nuk ushtrohen më nga AKM, ndërkohë që disa dispozita të ligjit nr.10431 vijnë të referojnë kompetenca të lidhura me kontrollin dhe inspektimin pranë AKM-së. Kjo situatë krijon pasiguri juridike dhe vështirësi në koordinimin ndërmjet AKM-së dhe strukturës përgjegjëse të inspektimit

Një problem tjetër i evidentuar gjatë zbatimit të ligjit lidhet me mungesën e instrumenteve të reja rregullatore dhe financiare që reflektojnë zhvillimet më të fundit të politikave evropiane dhe ndërkombëtare në fushën e mjedisit dhe klimës. Kuadri ligjor aktual nuk përmban dispozita të posaçme që mundësojnë zbatimin e masave për restaurimin e natyrës, si dhe nuk parashikon mekanizma për njohjen, verifikimin dhe certifikimin e aktiviteteve që kontribuojnë në largimin ose ruajtjen afatgjatë të karbonit. Në veçanti, mungesa e një baze ligjore për restaurimin e natyrës kufizon mundësinë e ndërmarrjes së masave të strukturuar për rikuperimin e ekosistemeve të degraduara, habitateve natyrore, zonave të mbrojtura dhe elementeve të biodiversitetit që kanë pësuar dëmtime nga aktivitetet njerëzore ose faktorët natyrorë. Kjo situatë vështirëson planifikimin dhe financimin e ndërhyrjeve afatgjata për përmirësimin e gjendjes së ekosistemeve dhe përmbushjen e objektivave kombëtare për ruajtjen e biodiversitetit si dhe redukton aftësinë e vendit për t'iu përgjigjur sfidave të reja që lidhen me mbrojtjen e natyrës dhe ndryshimet klimatike.

Nga pikëpamja ekonomike dhe operacionale, kjo situatë krijon pasoja konkrete edhe për aktorët në treg, duke përfshirë:

- pasiguri për operatorët ekonomikë lidhur me standardet dhe kërkesat që duhet të plotësojnë;
- kufizime në aksesin në mekanizma mbështetës financiarë për projekte mjedisore;
- vështirësi në përafrimin me kërkesat e tregut evropian dhe në përdorimin e instrumenteve të reja mjedisore.

Në aspektin institucional dhe të zbatimit, mungesa e harmonizimit dhe e përditësimit të kuadrit ligjor ndikon gjithashtu në:

- efikasitetin e kontrollit dhe mbikëqyrjes në terren, pasi paqartësitë në kuadrin ligjor në ndarjen e kompetencave dhe përgjegjësi ndërmjet institucioneve mund të sjellin mangësi në ushtrimin e funksioneve të kontrollit, mbivendosje të veprimtarive inspektuese ose vonesa në ndërmarrjen e masave administrative;
- koordinimin ndërmjet institucioneve përgjegjëse, duke vështirësuar shkëmbimin e informacionit, planifikimin e përbashkët të veprimeve administrative dhe zbatimin e një qasjeje të integruar për adresimin e problematikave mjedisore, veçanërisht në rastet kur përfshihen më shumë se një institucion përgjegjës;

- përdorimin eficient të burimeve publike, pasi mungesa e mekanizmave të qartë të koordinimit dhe financimit mund të çojë në shpërndarje jo optimale të fondeve, dublikim të aktiviteteve apo pamundësi për të orientuar investimet drejt prioriteteve më të rëndësishme mjedisore.

Për rrjedhojë, këto problematika ndikojnë drejtpërdrejt në ndërmarrjen e politikave mjedisore, në aftësinë e institucioneve për të garantuar mbrojtjen e mjedisit dhe në arritjen e objektivave kombëtare për zhvillim të qëndrueshëm. Në të njëjtën kohë, ato ndikojnë në adresimin në mënyrë efektive të sfidave që lidhen me mbrojtjen e biodiversitetit, restaurimin e ekosistemeve, përmirësimin e cilësisë së ajrit, ujërave dhe tokës, si dhe përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare dhe procesi i integritetit evropian në fushën e mjedisit.

Identifikoni shkaqet e problemit.

Kuadri ligjor për mbrojtjen e mjedisit nuk është përshtatur plotësisht me zhvillimet më të fundit në politikat mjedisore dhe klimatike, veçanërisht në drejtim të restaurimit të natyrës, mekanizmave për certifikimin e largimit të karbonit, financimit të veprimeve klimatike dhe nevojës për krijimin e instrumenteve të qëndrueshme financiare për mbështetjen e politikave mjedisore. Gjithashtu, ndryshimet institucionale të ndërmarra në kuadër të reformës së inspektimeve nuk janë reflektuar plotësisht në ligjin nr.10431, duke krijuar paqartësi në ndarjen e kompetencave ndërmjet institucioneve përgjegjëse për administrimin, monitorimin dhe kontrollin mjedisor.

Njëkohësisht, ligji nuk parashikon mekanizma të posaçëm për financimin e qëndrueshëm të projekteve dhe masave mjedisore, cka ka sjellë që mbështetja financiare të mbështetet kryesisht në burime të fragmentuara, si fondet buxhetore vjetore dhe projektet e financuara nga donatorët. Mungesa e një fondi të dedikuar dhe e një mekanizmi të strukturuar financiar ka kufizuar planifikimin afatgjatë të investimeve mjedisore dhe ka çuar në shpërndarjen e fragmentuar të burimeve financiare.

Si pasojë, ndërhyrjet në fushën e mjedisit kanë qenë shpesh të pjesshme dhe jo plotësisht të koordinuara, duke kufizuar efektivitetin e përdorimit të burimeve publike, mundësitë për mobilizimin e financimeve të reja dhe ndikimin real të politikave mjedisore në arritjen e objektivave kombëtare për mbrojtjen e mjedisit, biodiversitetit dhe klimës.

Përshkruani shtrirjen e problemit.

Problemi shtrihet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe prek administrimin e politikave mjedisore në nivel kombëtar dhe vendor. Mungesa e një mekanizmi financiar të qëndrueshëm dhe e një kuadri të plotë institucional ndikon në aftësinë e institucioneve përgjegjëse për të planifikuar, financuar dhe zbatuar në mënyrë efektive masat për mbrojtjen e mjedisit.

Pasojat reflektohen në të gjitha sektorët që kanë ndikim në mjedis, përfshirë menaxhimin e burimeve natyrore, mbrojtjen e biodiversitetit, restaurimin e ekosistemeve, përmirësimin e cilësisë së ajrit, ujërave dhe tokës, si dhe zbatimin e politikave për ndryshimet klimatike. Gjithashtu, problemi prek të gjitha institucionet publike që ushtrojnë funksione në fushën e mjedisit, njësitë e vetëqeverisjes vendore, operatorët ekonomikë, organizatat e shoqërisë civile dhe qytetarët, të cilët ndikohen drejtpërdrejt ose tërthorazi nga cilësia e mjedisit dhe nga efektiviteti i politikave publike.

Për shkak se kuadri ligjor aktual nuk parashikon mekanizma të mjaftueshëm për financimin e qëndrueshëm të ndërhyrjeve mjedisore dhe për integritetin e instrumenteve të reja të politikave

klimatike dhe të restaurimit të natyrës, problemi ka karakter kombëtar dhe kërkon një ndërhyrje të unifikuar në nivel të Republikës së Shqipërisë.

Identifikoni grupet e prekura nga ky problem.

- Qeveria (në planifikimin dhe administrimin e fondeve);
- Biznesi dhe individët (në mungesë të incentivave dhe mbështetjes);
- Shoqëria civile (në aksesin në financim);
- Qytetarët (në cilësinë e mjedisit).

Në veçanti, mungesa e një skeme të strukturuar financimi kufizon mundësitë e aktorëve të ndryshëm për të kontribuar në mënyrë aktive në mbrojtjen e mjedisit dhe për të përfituar nga instrumentet mbështetëse publike.

Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet përmes një ndryshimi të politikave.

Gjatë zbatimit në praktikë të ligjit, është evidentuar se financimi i projekteve mjedisore vazhdon të realizohet në mënyrë të shpërndarë dhe jo të unifikuar, pa një mekanizëm të qëndrueshëm dhe të dedikuar financiar. Kjo ka ndikuar në kufizimin e efektivitetit dhe vijimësisë së ndërhyrjeve në fushën e mjedisit.

Problemi mund të trajtohet përmes ndërhyrjes në kuadrin ligjor ekzistues ligjit bazë për mbrojtjen e mjedisit, pasi ai buron kryesisht nga boshllëqe dhe paqartësi të natyrës rregullatore dhe institucionale. Ndryshimet e propozuara synojnë krijimin e një mekanizmi të qëndrueshëm financiar nëpërmjet Fondit Kombëtar të Mjedisit, si dhe vendosjen e rregullave të qarta për financimin, përzgjedhjen dhe monitorimin e projekteve mjedisore.

Përveç aspektit financiar, ndërhyrja ligjore adreson edhe përmirësimin e organizimit institucional dhe në qartësimin e roleve dhe përgjegjësi të institucioneve përgjegjëse, sidomos në raport me funksionet e inspektimit, duke siguruar harmonizimin me legjislacionin përkatës në këtë fushë. Kjo pritet të reduktojë mbivendosjet dhe të përmirësojë koordinimin ndërinstitutional të inspektoratit qendror me AKM-në.

Gjithashtu, ndryshimet e propozuara mundësojnë përditësimin e kuadrit ligjor përmes përfshirjes së instrumenteve të rinj të politikave mjedisore, si restaurimi i natyrës dhe mekanizmat për njohjen dhe incentivimin e largimit të karbonit. Këto instrumente janë thelbësore për përafrimin me zhvillimet e fundit në politikat evropiane dhe për rritjen e efektivitetit të ndërhyrjeve në fushën e mjedisit.

Në tërësi, ndërhyrja ligjore do të ndikojë në koordinimin për hartimin dhe zbatimin e politikave mjedisore, duke forcuar kapacitetet shtetërore për financim, monitorim dhe mbikëqyrje, si dhe duke rritur transparencën dhe eficiencën në përdorimin e fondeve publike.

Arsyeja e ndërhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
- *Identifikoni shkallën e ndërhyrjes së qeverisë që nevojitet për të trajtuar problemin.*
- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*
- *Shpjegoni pse qeveria e sheh të nevojshme të ndërhyjë.*

Qeveria e shih të nevojshme ndërhyrjen për shkak të problematikave të identifikuara në kuadrin ligjor aktual, veçanërisht në mungesën e një mekanizmi të qëndrueshëm dhe të strukturuar financiar për mbështetjen e projekteve në fushën e mjedisit, duke kufizuar efektivitetin e ndërhyrjeve dhe arritjen e objektivave strategjikë në këtë fushë.

Përtej dimensionit financiar, ndërhyrja konsiderohet e nevojshme edhe për shkak të paqartësive të evidentuara në organizimin institucional dhe në ndarjen e kompetencave ndërmjet institucioneve përgjegjëse lidhur me fushën e inspektimit në mjedis. Zhvillimet e fundit të kuadrit ligjor në fushën e inspektimeve dhe riorganizimi institucional i funksioneve të kontrollit dhe inspektimit nuk janë reflektuar plotësisht në ligjin nr.10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar. Si rezultat, në disa dispozita të ligjit vazhdojnë të ekzistojnë referenca që nuk pasqyrojnë në mënyrë të plotë ndarjen aktuale të funksioneve ndërmjet Ministrisë përgjegjëse për mjedisin, Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM) dhe strukturës shtetërore përgjegjëse për inspektimin mjedisor.

Aktualisht, pas reformës së inspektimeve, AKM-ja ushtron kryesisht funksione teknike, monitoruese dhe raportuese në fushën e mjedisit, ndërsa funksionet e inspektimit dhe kontrollit administrativ ushtrohen nga strukturat përgjegjëse të inspektimit. Mosreflektimi i plotë i këtyre ndryshimeve në ligjin bazë ka krijuar paqartësi në interpretimin e kompetencave, mundësi për mbivendosje institucionale dhe vështirësi në koordinimin ndërmjet institucioneve përgjegjëse për monitorimin, kontrollin dhe zbatimin e legjislacionit mjedisor.

Gjithashtu, mungesa e një mekanizmi të qartë institucional për administrimin, përzgjedhjen, financimin dhe monitorimin e projekteve mjedisore ka kufizuar koordinimin ndërmjet ministrisë, institucioneve të varësisë, njërive të vetëqeverisjes vendore dhe aktorëve të tjerë përfitues. Për rrjedhojë, ndërhyrja ligjore synon qartësimin e roleve dhe përgjegjësisë të secilit institucion, eliminimin e mbivendosjeve të kompetencave dhe krijimin e një kuadri institucional më efikas për zbatimin e politikave mjedisore.

Në mënyrë të veçantë, zhvillimet e fundit në kuadrin institucional, si reforma e inspektoriateve, nuk janë reflektuar plotësisht në ligjin ekzistues, duke krijuar vështirësi në koordinimin ndërinstitutional dhe në zbatimin efektiv të funksioneve të lidhura me mbrojtjen e mjedisit. Një tjetër arsye që justifikon ndërhyrjen lidhet me mospërfshirjen e disa mekanizma të rëndësishëm që lidhen me zhvillimet e fundit në nivel evropian dhe ndërkombëtar, si restaurimi i natyrës dhe mekanizmat për incentivimin e largimit të karbonit, të cilat janë tashmë pjesë e qasjeve moderne të menaxhimit mjedisor. Në këtë kontekst, ndërhyrja synon të trajtojë në mënyrë të drejtpërdrejtë këto gjetje, duke krijuar një bazë më të plotë dhe të integruar rregullatore si dhe vendosjen e një sistemi të qëndrueshëm financiar, përmirësimin e organizimit institucional dhe përafrimin e kuadrit ligjor me zhvillimet më të fundit të politikave të Bashkimit Evropian. Për rrjedhojë, ndërhyrja konsiderohet e domosdoshme dhe proporcionale, pasi adreson shkaqet kryesore të problemit dhe krijon kushtet për një zbatim më efektiv, më të koordinuar dhe më transparent të politikave mjedisore në vend.

- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje*

Nga ana tjetër, zhvillimet e fundit në politikat ndërkombëtare dhe evropiane, veçanërisht për ndryshimet klimatike, restaurimin e natyrës dhe tranzicionin drejt një ekonomie të gjelbër, kërkojnë përditësimin e instrumenteve kombëtare ligjore dhe financiare.

Nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje, synohet krijimi i një fondi të dedikuar për mjedisin, vendosja e rregullave të qarta për financimin dhe përzgjedhjen e projekteve, si dhe përmirësimi i organizimit institucional. Gjithashtu, ndërhyrja synon të mbështesë instrumente të reja si restaurimi i natyrës dhe incentivimi i aktiviteteve që kontribuojnë në reduktimin e ndikimeve mjedisore.

- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*

Kjo ndërhyrje mbështet objektivat e përcaktuara në dokumentet strategjike kombëtare për mbrojtjen e mjedisit, zhvillimin e qëndrueshëm dhe integrimin evropian. Në veçanti, ajo lidhet me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI), e cila parashikon forcimin e qeverisjes mjedisore, përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe përmirësimin e cilësisë së mjedisit, si dhe me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) në kuadër të Kapitullit 27 "Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike", i cili përcakton detyrimet për përafrimin e legjislacionit dhe politikave kombëtare me aktet e Bashkimit Evropian.

- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë*

Në fushën e mbrojtjes së mjedisit, Republika e Shqipërisë ka ndërmarrë një sërë reformash ligjore, institucionale dhe administrative, me synim forcimin e mbrojtjes së mjedisit dhe përafrimin gradual të legjislacionit kombëtar me acquis të Bashkimit Evropian.

Baza e kuadrit ligjor përbëhet nga ligji nr. 10431, datë 9.6.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit", i ndryshuar, i cili ka përcaktuar parimet, instrumentet dhe institucionet përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit. Në zbatim të këtij ligji janë miratuar një sërë aktesh nënligjore që rregullojnë procedurat për vlerësimin e ndikimit në mjedis, lejet mjedisore, monitorimin, kontrollin dhe administrimin e informacionit mjedisor.

Paralelisht, janë miratuar dhe përditësuar legjislacione sektoriale në fusha si mbrojtja e biodiversitetit, menaxhimi i mbetjeve, cilësia e ajrit, mbrojtja e ujërave, ndryshimet klimatike dhe kontrolli i ndotjes, duke krijuar një kuadër gjithnjë e më të plotë rregullator.

Në kuadër të procesit të integritetit evropian, Shqipëria ka vijuar përafrimin e legjislacionit me acquis të Bashkimit Evropian në kapitullin 27 "Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike", si dhe ka përmbushur detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit dhe dokumentet strategjike të integritetit evropian.

Gjithashtu, Republika e Shqipërisë është palë në një sërë konventash shumëpalëshe ndërkombëtare në fushën e mjedisit, të tilla si Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC), Marrëveshja e Parisit, Konventa për Diversitetin Biologjik (CBD), Konventa e Bernës, Konventa e Ramsarit, Konventa e Bazelit, Konventa e Stokholmit, Konventa e Roterdamit dhe instrumente të tjera ndërkombëtare që lidhen me mbrojtjen e mjedisit dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore.

Në nivel institucional, janë ndërmarrë masa për forcimin e kapaciteteve të institucioneve përgjegjëse për administrimin e mjedisit, përmirësimin e sistemeve të monitorimit dhe raportimit, si dhe harmonizimin e funksioneve institucionale me reformat e administratës publike, përfshirë reformën në fushën e inspektimeve. Këto masa kanë krijuar bazën për zhvillimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor, por kanë evidentuar gjithashtu nevojën për përmirësimin e mekanizmave financiarë dhe institucionalë që mbështesin zbatimin efektiv të politikave mjedisore.

Objektivi i politikës

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
- *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*

Objektivi i ndërhyrjes ligjore është përmirësimi i kuadrit ligjor dhe institucional në fushën e mbrojtjes së mjedisit, nëpërmjet forcimit të mekanizmave financiarë, përmirësimit të koordinimit institucional dhe krijimit të instrumenteve të reja për mbështetjen e politikave mjedisore dhe klimatike.

Objektivat specifikë që synohen të arrihen:

Të krijohet Fondi Kombëtar i Mjedisit brenda vitit 2027 si mekanizëm i qëndrueshëm për financimin e projekteve mjedisore.

Ulja rasteve të mbivendosjeve dhe konflikteve të kompetencave ndërmjet institucioneve përgjegjëse nëpërmjetqartësimit të kompetencave të institucioneve ndërmjet institucioneve përgjegjëse brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit.

Të mundësohet, deri në vitin 2028, krijimi i bazës ligjore për zbatimin e instrumenteve të reja të politikës klimatike, përfshirë certifikimin e largimit të karbonit, në përputhje me acquis të Bashkimit Evropian.

Rritja me 30% e numrit të projekteve mjedisore të financuara përmes Fondit Kombëtar të Mjedisit gjatë tre viteve të para, krahasuar me nivelin bazë të financimit publik para krijimit të fondit.

Rritja deri në 200,000,000 lekë e financimeve për projektet mjedisore brenda pesë viteve nga funksionimi i fondit.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë zgjedhur opsionet e renditura.*

Për arritjen e objektivave të politikës janë shqyrtuar opsionet e mëposhtme:

Opsioni 0 (status quo): - Nuk ndërhyhet me ndryshim apo politikë të re dhe vijohet me kuadrin ligjor ekzistues pa ndërhyrje.

Ky opsion konsiston në vijimin e zbatimit të kuadrit ligjor ekzistues pa ndërmarrë ndryshime ligjore apo masa të reja rregullatore. Në këtë rast, ligji nr.10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar, do të vazhonte të zbatohet në formën aktuale, pa përfshirë instrumentet e reja të propozuara dhe pa adresuar problematikat e identifikuara gjatë zbatimit të tij.

Avantazhet

- Nuk kërkon ndryshime në kuadrin ligjor ekzistues.
- Nuk krijon kosto të menjëhershme administrative apo procedurale që lidhen me hartimin dhe zbatimin e ndryshimeve ligjore.
- Nuk kërkon miratimin e akteve të reja nënligjore apo riorganizime institucionale.
- Ruan stabilitetin e kuadrit rregullator ekzistues në afat të shkurtër.

Disavantazhet

- Nuk adreson mungesën e një mekanizmi të qëndrueshëm financiar për financimin e politikave dhe projekteve mjedisore.

- Nuk mundëson krijimin e Fondit Kombëtar të Mjedisit dhe vazhdon situatën aktuale të fragmentimit të burimeve financiare.
- Nuk zgjidh paqartësitë e evidentuara në organizimin institucional dhe ndarjen e kompetencave ndërmjet institucioneve përgjegjëse.
- Nuk krijon bazën ligjore për përfshirjen e instrumenteve të reja, si restaurimi i natyrës dhe certifikimi i largimit të karbonit.
- Kufizon aftësinë e vendit për t'iu përgjigjur zhvillimeve të reja të politikave mjedisore dhe klimatike në nivel evropian dhe ndërkombëtar.
- Nuk përmirëson kapacitetet për mobilizimin e financimeve të reja kombëtare dhe ndërkombëtare në mbështetje të projekteve mjedisore.
- Rrezikon vijimin e ndërhyrjeve të pjesshme dhe jo plotësisht të koordinuara në fushën e mbrojtjes së mjedisit.

Vlerësimi i opsionit

Megjithëse ky opsion nuk sjell kosto shtesë në afat të shkurtër, ai nuk adreson asnjë nga problematikat kryesore të identifikuara gjatë zbatimit të ligjit. Mungesa e një fondi të dedikuar, mosreflektimi i zhvillimeve institucionale dhe mungesa e instrumenteve moderne të politikave mjedisore do të vazhdonin të kufizonin efektivitetin e ndërhyrjeve në fushën e mjedisit. Për rrjedhojë, ky opsion nuk mundëson arritjen e objektivave të politikës dhe nuk konsiderohet një alternativë e përshtatshme për trajtimin e problematikave të evidentuara.

Opsioni 1 (jo rregullator) – Vetërregullimi dhe gjetja e zgjidhjeve përmes mekanizmave jorregullatore.

Ky opsion konsiston në trajtimin e problematikave të evidentuara përmes instrumenteve jorregullatore, si fushatat e ndërgjegjësimit publik, promovimi i praktikave vullnetare, bashkëpunimi ndërinstitucional, mbështetja e iniciativave të sektorit privat dhe organizatave të shoqërisë civile, si dhe zhvillimi i udhëzimeve ose praktikave jo detyruese për zbatimin e politikave mjedisore.

Avantazhet

- Nuk kërkon ndryshime në kuadrin ligjor ekzistues.
- Ka kosto fillestare më të ulëta administrative dhe financiare.
- Mund të zbatohet në një afat më të shkurtër përmes masave organizative dhe ndërgjegjëse.
- Ofron fleksibilitet më të madh për institucionet dhe aktorët e përfshirë.
- Mund të kontribuojë në rritjen e ndërgjegjësimit publik dhe pjesëmarrjes vullnetare në mbrojtjen e mjedisit.

Disavantazhet

- Nuk adreson boshllëqet e identifikuara në kuadrin ligjor dhe institucional.
- Nuk mundëson krijimin e Fondit Kombëtar të Mjedisit dhe të një mekanizmi të dedikuar financiar për mbështetjen e projekteve mjedisore.
- Nuk mund të zgjidhë paqartësitë në ndarjen e kompetencave ndërmjet institucioneve përgjegjëse.
- Nuk krijon bazë ligjore për restaurimin e natyrës dhe certifikimin e largimit të karbonit.

- Mbështetet kryesisht në gatishmërinë vullnetare të aktorëve dhe nuk garanton zbatim të njëtrajtshëm në nivel kombëtar.
- Ka ndikim të kufizuar dhe jo të qëndrueshëm në kohë për shkak të mungesës së instrumenteve detyruese dhe burimeve të dedikuara financiare.

Opsioni 2: Hartimi i një ligji të ri për mbrojtjen e mjedisit.

Ky opsion konsiston në rishikimin e plotë të kuadrit ligjor ekzistues dhe zëvendësimin e ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar, me një ligj të ri që do të rregullonte në mënyrë të integruar të gjitha aspektet e mbrojtjes së mjedisit.

Avantazhet:

- Mundëson një rishikim të plotë dhe të integruar të kuadrit ligjor në fushën e mjedisit.
- Ofron mundësinë për të reflektuar në një akt të vetëm të gjitha zhvillimet e fundit ligjore, institucionale dhe politike në fushën e mjedisit dhe klimës.
- Mundëson harmonizim më të gjerë me legjislacionin dhe politikat më të fundit të Bashkimit Evropian.
- Krijon mundësinë për ristrukturimin e plotë të instrumenteve, procedurave dhe kompetencave institucionale.
- Mund të eliminojë në mënyrë sistematike dispozitat e vjetruara ose referencat që nuk janë më në përputhje me kuadrin aktual institucional.

Disavantazhet:

- Kërkon kohë më të gjatë për hartim, konsultim, koordinim ndërinstitutional dhe miratim.
- Shoqërohet me kosto më të larta administrative dhe përdorim më të madh të burimeve njerëzore krahasuar me ndryshimin e ligjit ekzistues.
- Kërkon rishikimin e një numri të konsiderueshëm aktesh nënligjore ekzistuese dhe përshtatjen e tyre me ligjin e ri.
- Mund të krijojë pasiguri juridike gjatë periudhës së tranzicionit nga kuadri ekzistues drejt kuadrit të ri ligjor.
- Nuk konsiderohet proporcional me problematikat e identifikuara, pasi ndërhyrjet e propozuara janë të kufizuara dhe nuk prekin strukturën themelore të ligjit në fuqi.
- Nuk i përgjigjet nevojës për ndërhyrje të menjëhershme për adresimin e boshllëqeve financiare, institucionale dhe rregullatore të evidentuara gjatë zbatimit të ligjit.

Opsioni 3: I preferuar - Ndryshimi i ligjit ekzistues “Për mbrojtjen e mjedisit” i ndryshuar”.

Avantazhet:

- Adreson drejtpërdrejt problematikat e identifikuara gjatë zbatimit të ligjit në fuqi.
- Mundëson krijimin e Fondit Kombëtar të Mjedisit si një mekanizëm i qëndrueshëm dhe transparent për financimin e politikave dhe projekteve mjedisore.
- Përfshin instrumente të reja të politikave mjedisore dhe klimatike, si restaurimi i natyrës dhe certifikimi i largimit të karbonit.
- Harmonizon kuadrin ligjor kombëtar me zhvillimet më të fundit të legjislacionit dhe politikave të Bashkimit Evropian.
- Përmirëson organizimin institucional dhe qartëson kompetencat e institucioneve përgjegjëse.

- Siguron vazhdimësinë e kuadrit ligjor ekzistues, duke shmangur nevojën për një rishikim të plotë të legjislacionit.
- Ka kosto më të ulëta financiare dhe administrative krahasuar me hartimin e një ligji të ri.
- Mund të hartohet, miratohet dhe zbatohet në një afat më të shkurtër.
- Redukton pasiguritë ligjore për administratën publike dhe subjektet që zbatojnë legjislacionin mjedisor.
- Lehtëson zbatimin e angazhimeve të Shqipërisë në kuadër të procesit të integritetit evropian dhe konventave ndërkombëtare në fushën e mjedisit.
- Është proporcional me natyrën e ndërhyrjes, pasi ndryshimet janë të kufizuara dhe nuk prekin strukturën themelore të ligjit në fuqi.

Disavantazhet:

- Kërkon hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore për zbatimin e dispozitave të reja.
- Kërkon ngritjen ose forcimin e kapaciteteve administrative të institucioneve përgjegjëse për administrimin e Fondit Kombëtar të Mjedisit.
- Mund të sjellë kosto fillestare për organizimin institucional, ngritjen e strukturave administrative dhe zhvillimin e procedurave të reja.
- Kërkon trajnim të administratës dhe institucioneve përgjegjëse për zbatimin e instrumenteve të reja.
- Efektiviteti i plotë i ndërhyrjes varet nga sigurimi i burimeve financiare dhe zbatimi korrekt i akteve nënligjore.
- Mund të jetë e nevojshme përshtatja e disa akteve të tjera ligjore ose nënligjore për të garantuar harmonizimin e plotë të kuadrit juridik.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- *Identifikoni se kush preket.*
- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
- *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
 - *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (shih aneksin 1/a për tabelën që mund të përdorni).*
 - *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.*
- *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*
- *Diskutoni kufizimin e analizës:*
 - *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
 - *Tregoni sa të forta, të pavarura dhe të rëndësishme janë provat që mbështesin supozimet.*
 - *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*
- *Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:*
 - *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*
 - *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*

Paraqisni përlllogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (shih aneksin 1/b për tabelën që mund të përdorni).

Grupet e prekura

Ministria përgjegjëse për mjedisin dhe institucionet publike përgjegjëse

Ndikimi institucional

- Krijimi i Fondit Kombëtar të Mjedisit forcon kuadrin institucional për financimin e politikave mjedisore dhe klimatike.
- Qartësohen kompetencat ndërmjet institucioneve përgjegjëse për administrimin, monitorimin dhe kontrollin mjedisor, duke reduktuar mbivendosjet funksionale.
- Krijohen mekanizma të rinj për koordinimin dhe monitorimin e përdorimit të fondeve.

Ndikimi administrativ

- Kërkohet hartimi i akteve nënligjore për organizimin dhe funksionimin e fondit.
- Kërkohet ngritja e procedurave të aplikimit, vlerësimit, monitorimit dhe raportimit të projekteve.
- Nevojitet trajnim i personelit dhe forcim i kapaciteteve administrative.

Ndikimi financiar

- Kosto fillestare për ngritjen dhe funksionalizimin e fondit.
- Kosto operative vjetore për administrimin, monitorimin dhe auditimin e fondeve.
- Kosto për ngritjen e sistemeve të raportimit dhe kontrollit.

Ndikimi afatshkurtër

- Rritje e ngarkesës administrative gjatë fazës së ngritjes së fondit.

Ndikimi afatmesëm dhe afatgjatë

- Përmirësim i eficiencës së financimit të projekteve mjedisore.
- Rritje e kapacitetit institucional për përdorimin e fondeve kombëtare dhe ndërkombëtare.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore

Ndikimi financiar

- Krijohen mundësi të reja financimi për projekte mjedisore, klimatike dhe të restaurimit të natyrës.
- Rritet potenciali për tërheqjen e investimeve në nivel vendor.

Ndikimi administrativ

- Bashkitë duhet të përgatisin projekte, aplikime dhe raporte monitorimi.
- Kërkohet forcim i kapaciteteve teknike për menaxhimin e fondeve.

Ndikimi social dhe mjedisor

- Përmirësohet infrastruktura mjedisore lokale.
- Rritet cilësia e shërbimeve mjedisore për komunitetet.

Ndikimet negative / kostot

- Bashkitë me kapacitete të kufizuara mund të kenë vështirësi në përgatitjen dhe administrimin e projekteve.
- Mund të nevojiten burime shtesë njerëzore dhe financiare për përmbushjen e kërkesave procedurale.

Biznesi

Ndikimi financiar

- Bizneset do të kenë mundësi të aplikojnë për financim të projekteve mjedisore dhe klimatike.
- Krijohen mundësi të reja për investime në teknologji të gjelbra dhe aktivitete të lidhura me largimin e karbonit.
- Krijimin e bazës ligjore për certifikimin e largimit të karbonit, do të krijojë kushte për zhvillimin e aktiviteteve që kontribuojnë në absorbimin ose ruajtjen afatgjatë të karbonit, si dhe mund të krijojë mundësi të reja ekonomike për bizneset, pronarët e tokave, komunitetet lokale dhe aktorë të tjerë të angazhuar në veprimtari me ndikim pozitiv klimatik.

Ndikimi në kostot administrative

- Zbatimi i projektligjit nuk parashikon krijimin e strukturave të reja administrative apo shtim të burimeve njerëzore. Funksionet e administrimit të Fondit Kombëtar të Mjedisit dhe vlerësimit të projekteve do të realizohen nga strukturat ekzistuese të ministrisë përgjegjëse për mjedisin. Nisur nga praktika e deritanishme, është shumë e mundur që këto trajnime të mbështeten financiarisht nga projekte të financuara nga organizatat partnere ndërkombëtare. Për rrjedhojë, nuk parashikohen kosto administrative shtesë për buxhetin e shtetit.
- **Ndikimi në konkurrueshmëri**
- Ndërhyrja nuk krijon barriera të reja hyrëse në treg.
- Mund të favorizohen subjektet që disponojnë kapacitete më të mëdha teknike dhe financiare për përgatitjen e projekteve.
- Për të shmangur shtrembërimet e konkurrencës, kriteret e financimit duhet të jenë transparente dhe të aksesueshme për NVM-të.

Ndikimi afatgjatë

- Rritet konkurrueshmëria përmes adoptimit të teknologjive më efikase dhe të qëndrueshme.

Organizatat jofitimprurëse

- Do të kenë akses më të madh në financimin publik për projekte mjedisore dhe do të mund të luajnë rol më aktiv në zbatimin dhe monitorimin e politikave mjedisore.
- Kosto administrative për përgatitjen dhe raportimin e projekteve.

Qytetarët

Ndikimi social

- Përmirësim i cilësisë së jetës dhe i shëndetit publik si rezultat i investimeve në mjedis.
- Rritje e ndërgjegjësimit për mbrojtjen e mjedisit dhe ndryshimet klimatike.

Ndikimi mjedisor

- Përmirësim i gjendjes së ekosistemeve, biodiversitetit dhe cilësisë së mjedisit.

Ndikimi ekonomik

- Përfitime indirekte nga investimet publike dhe private në sektorin mjedisor.
- Potencial për krijimin e vendeve të reja të punës në ekonominë e gjelbër.

Analiza sasiore, monetare dhe cilësore

Bazuar në alokimet e parashikuara, Fondi Kombëtar i Mjedisit pritet të financojë projekte në fushën e mbrojtjes së mjedisit, restaurimit të natyrës dhe veprimit klimatik. Financimi i parashikuar është 100 milionë lekë në vitin e parë të funksionimit dhe rreth 100 milionë lekë në vit për vitet pasuese të periudhës së analizuar. Këto fonde do të përdoren për mbështetjen e projekteve të paraqitura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, organizatat jofitimprurëse, bizneset, institucionet akademike dhe subjekte të tjera që ushtrojnë veprimtari në fushën e mjedisit.

Sipas llogaritjeve të kryera në analizën financiare, vlera aktuale e fondeve të planifikuara për t'u alokuar dhe shpërndarë për përfituesit në horizontin kohor 10-vjeçar vlerësohet në rreth 812.367,000 lekë. Meqenëse këto fonde përfaqësojnë një transferim financiar nga buxheti i shtetit tek përfituesit e skemës, vlera aktuale e përfitimeve financiare të drejtpërdrejta rezulton në të njëjtin nivel.

Nga këndvështrimi cilësor, ndërhyrja pritet të sjellë përfitime institucionale dhe administrative, duke forcuar mekanizmat e financimit mjedisor, duke përcaktuar më qartë përgjegjësitë e institucioneve përkatëse dhe duke mbështetur zbatimin e masave në fushën e mjedisit dhe klimës.

Gjithashtu, krijohen kushte më të favorshme për mobilizimin e financimeve kombëtare dhe ndërkombëtare në mbështetje të objektivave mjedisore dhe klimatike.

Ndikimi në mjedis

Ndikimi në mjedis vlerësohet pozitiv. Krijimi i Fondit Kombëtar të Mjedisit pritet të rrisë financimin për projekte që kontribuojnë drejtpërdrejt në mbrojtjen e mjedisit, restaurimin e ekosistemeve natyrore, ruajtjen e biodiversitetit, rehabilitimin e zonave të degraduara dhe forcimin e masave për zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike. Gjithashtu, krijimi i kuadrit për certifikimin e largimit të karbonit pritet të nxisë aktivitete që kontribuojnë në absorbimin dhe ruajtjen afatgjatë të karbonit, duke mbështetur arritjen e objektivave kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e klimës. Në afat të gjatë, ndërhyrja pritet të ndikojë në përmirësimin e treguesve mjedisorë, rritjen e reziliencës ndaj ndryshimeve klimatike dhe forcimin e investimeve të gjelbra në nivel kombëtar.

Analiza kohore

Afatshkurtër: ngritja e fondit, miratimi i akteve nënligjore dhe organizimi institucional. Afatmesëm: rritja e numrit të projekteve të financuara dhe funksionalizimi i instrumenteve të reja.

Afatgjatë: përmirësimi i treguesve mjedisorë, rritja e investimeve të gjelbra dhe forcimi i politikave klimatike.

Rreziqet kryesore

- vonesa në miratimin e akteve nënligjore;
- mungesa ose reduktimi i financimit;
- interes i kufizuar për aplikime në fazën fillestare;
- mungesa e kapaciteteve në disa institucione ose bashki;
- vështirësi në monitorimin e projekteve të financuara.

Përfituesit kryesorë të ndërhyrjes janë bashkitë, organizatat jofitimprurëse, bizneset dhe qytetarët përmes përmirësimit të cilësisë së mjedisit dhe aksesit në financime. Kostot kryesore

mbulohen nga buxheti i shtetit përmes financimit dhe administrimit të Fondit Kombëtar të Mjedisit.

Përmbledhja e vlerësimit të opsioneve

Nga analiza e opsioneve të shqyrtuara rezulton se secili prej tyre ka ndikime të ndryshme në raport me problemet e identifikuar dhe objektivat e politikës.

Opsioni 0 (status quo) nuk sjell kosto shtesë administrative apo financiare, por nuk adreson mungesën e një mekanizmi të qëndrueshëm financiar, paqartësitë institucionale dhe mungesën e instrumenteve të reja të politikave mjedisore. Si pasojë, problematikat ekzistuese do të vazhdonin dhe ndikimet pozitive në mjedis do të mbeteshin të kufizuara.

Opsioni 1 (jo rregullator) paraqet kosto relativisht të ulëta dhe mund të kontribuojë në rritjen e ndërgjegjësimit dhe pjesëmarrjes vullnetare, por nuk krijon mekanizma të detyrueshëm financiarë dhe institucionalë, nuk zgjidh boshllëqet ligjore dhe nuk garanton rezultate të qëndrueshme në nivel kombëtar.

Opsioni 2 (hartimi i një ligji të ri) do të mundësonte një rishikim të plotë të kuadrit ligjor dhe adresimin e problematikave të identifikuar, por kërkon më shumë kohë, burime financiare dhe administrative. Për më tepër, rezultatet e pritshme janë të ngjashme me ato të opsionit 3, ndërsa kostot dhe ngarkesa institucionale janë dukshëm më të larta.

Opsioni 3 (ndryshimi i ligjit ekzistues) adreson drejtpërdrejt problematikat e konstatuara përmes krijimit të Fondit Kombëtar të Mjedisit, përfshirjes së instrumenteve të reja si restaurimi i natyrës dhe certifikimi i largimit të karbonit, si dhe qartësimin të roleve institucionale. Ky opsion paraqet raportin më të favorshëm ndërmjet kostove dhe përfitimeve dhe siguron ndërhyrjen më të shpejtë dhe më proporcionale për arritjen e objektivave të politikës.

Krahasimi i ndikimeve të opsioneve

Në krahasim me opsionet e tjera, opsioni 3 rezulton më efektiv në:

- adresimin e problemit të financimit mjedisor;
- përmirësimin e organizimit institucional dhe koordinimit ndërinstitutional;
- përfshirjen e instrumenteve të reja të politikave mjedisore dhe klimatike;
- mbështetjen e projekteve mjedisore përmes një mekanizmi të dedikuar financiar;
- përmirësimin afatgjatë të treguesve mjedisorë dhe klimatikë.

Përfitimet e drejtpërdrejta monetare lidhen me financimin e projekteve mjedisore për bashkitë, organizatat jofitimprurëse, bizneset dhe subjektet e tjera përfituese. Përfitimet afatgjata mjedisore, sociale dhe ekonomike nuk mund të monetizohen me saktësi në këtë fazë, por vlerësohet se tejkalojnë kostot fillestare të ndërhyrjes. Për këtë arsye, analiza me shumë kritere është konsideruar metoda më e përshtatshme për vlerësimin e alternativave dhe ka identifikuar opsionin 3 si alternativën më të favorshme.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.

Risite kryesore të opsionit të preferuar

Opsioni i preferuar parashikon ndërhyrje të targetuara në ligjin nr.10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar, me qëllim adresimin e problematikave të evidentuara gjatë zbatimit të tij.

Risitë kryesore të projektligjit konsistojnë në:

- krijimin e Fondit Kombëtar të Mjedisit si mekanizëm i dedikuar financiar për mbështetjen e projekteve dhe programeve në fushën e mjedisit;
- përcaktimin e rregullave dhe procedurave për financimin, përzgjedhjen dhe monitorimin e projekteve mjedisore;
- përfshirjen e restaurimit të natyrës si instrument i ri i politikave mjedisore;
- krijimin e bazës ligjore për certifikimin e largimit të karbonit dhe incentivimin e aktiviteteve që kontribuojnë në absorbimin ose ruajtjen afatgjatë të karbonit;
- qartësimin e kompetencave institucionale dhe harmonizimin e ligjit me zhvillimet e fundit të kuadrit institucional në fushën e inspektimeve;
- përmirësimin e koordinimit ndërmjet institucioneve përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikave mjedisore.

Metoda e vlerësimit të opsioneve

Për shkak se një pjesë e konsiderueshme e ndikimeve të pritshme janë të natyrës institucionale, mjedisore dhe sociale dhe nuk mund të monetizohen në mënyrë të plotë dhe të besueshme në këtë fazë, vlerësimi i opsioneve është kryer nëpërmjet metodës së analizës me shumë kritere (Multi-Criteria Analysis – MCA). Kjo metodë mundëson krahasimin e alternativave jo vetëm mbi bazën e kostove financiare, por edhe duke marrë në konsideratë aftësinë e tyre për të adresuar problemin, realizueshmërinë e tyre, ndikimin në përmirësimin e politikave mjedisore dhe efektivitetin institucional.

Për këtë qëllim janë marrë në konsideratë katër opsione:

1. Opsioni 0 – Ruajtja e status quo-së;
2. Opsioni 1 – Opsioni jorregullator;
3. Opsioni 2 – Hartimi i një ligji të ri për mbrojtjen e mjedisit;
4. Opsioni 3 – Ndryshimi i ligjit ekzistues “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar.

Duke pasur parasysh komentet e Drejtorisë së RIA-s, sugjeroj që kriteret të riformulohen si më poshtë:

1. Aftësia për të adresuar problemin e financimit të politikave mjedisore (pesha 5);
2. Efikasiteti institucional dhe qartësia e kompetencave (pesha 4);
3. Ndikimi në përmirësimin e mbrojtjes së mjedisit dhe rezultateve mjedisore (pesha 3);
4. Realizueshmëria dhe shpejtësia e zbatimit (pesha 3);
5. Kosto-efektiviteti i ndërhyrjes (pesha 5).

Këto kritere lidhen drejtpërdrejt me problematikën dhe objektivat e përcaktuara në RIA dhe krijojnë një bazë më të qartë për krahasimin e katër opsioneve.

Në tabelën e mëposhtme janë vlerësuar opsionet me pikë (nga 1-5) duke iu referuar çdo kriteri

Kriteret	Pesha	Opsioni 0	Opsioni 1	Opsioni 2	Opsioni 3
Aftësia për të adresuar problemin e financimit të politikave mjedisore	5	3 (15)	3 (15)	5 (25)	5 (25)
Efikasiteti institucional dhe qartësia e kompetencave	4	3 (12)	3 (12)	4 (16)	4 (16)

Ndikimi në përmirësimin e mbrojtjes së mjedisit dhe rezultateve mjedisore	3	0 (0)	1 (3)	3 (9)	3 (9)
Realizueshmëria dhe shpejtësia e zbatimit	3	2 (6)	2 (6)	3 (9)	3 (9)
Kosto- efektiviteti i ndërhyrjes	5	1 (5)	2 (10)	3 (15)	5 (25)
Pikët		42	46	74	84

Sipas metodës multikriteret opsioni 3, konsiderohet si opsioni me i mire i mundshëm që vlerësohet me pikë më të larta për përmbushjen e kriterëve .

Çështje të zbatimit

- *Shpjegoni se cila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*
- *Specifikoni të gjitha kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit.*

Zbatimi i opsionit të zgjedhur (ndryshimi i ligjit ekzistues) i ngarkohet kryesisht ministrisë përgjegjëse për mjedisin, si autoriteti kryesor për administrimin e Fondit Kombëtar të Mjedisit, koordinimin e politikave dhe zbatimin e dispozitave të reja (restaurimi i natyrës, certifikimi i karbonit).

Gjithashtu, Këshilli i Ministrave që miraton aktet nënligjore përkatëse; Strukturat teknike (kolegjiumi/komisionet) të cilat realizojnë vlerësimin dhe përzgjedhjen e projekteve si dhe strukturat e inspektimit pranë AKM-së të cilat kontribuojnë në zbatimin dhe monitorimin në terren.

Pengesat e mundshme

Gjatë zbatimit të opsionit të preferuar, mund të hasen disa pengesa që lidhen kryesisht me fazat fillestare të zbatimit të kuadrit të ri ligjor dhe institucional. Këto pengesa nuk janë të pazakonta për ndërhyrje të kësaj natyre dhe lidhen kryesisht me nevojën për përshtatje graduale të strukturave dhe proceseve ekzistuese.

Në veçanti, një ndër sfidat kryesore lidhet me miratimin në kohë të akteve nënligjore, të cilat janë thelbësore për zbatimin praktik të ligjit. Çdo vonesë në këtë drejtim mund të ndikojë në funksionalizimin e plotë të mekanizmave të rinj, përfshirë Fondin Kombëtar të Mjedisit dhe skemat përkatëse të financimit.

Një element tjetër që mund të ndikojë është niveli i pjesëmarrjes nga subjektet përfituese, i cili në fazat e para mund të jetë më i kufizuar për shkak të mungesës së informacionit ose njohjes së plotë të skemave të reja.

Megjithatë, këto pengesa konsiderohen të menaxhueshme dhe mund të adresohen përmes një sërë masash mbështetëse. Në këtë drejtim, një rol të rëndësishëm luan hartimi dhe miratimi në kohë i akteve nënligjore, të cilat duhet të jenë të qarta dhe të zbatueshme në praktikë. Paralelisht, forcimi i kapaciteteve institucionale përmes trajnimeve dhe mbështetjes teknike kontribuon në rritjen e eficiencës së administrimit të fondeve dhe mekanizmave të rinj.

Vendosja e procedurave të qarta dhe transparente për përzgjedhjen dhe financimin e projekteve shërben gjithashtu për të rritur besimin e publikut dhe për të nxitur pjesëmarrjen.

Në të njëjtën kohë, informimi dhe ndërgjegjësimi i subjekteve të interesuara mbi mundësitë e financimit dhe instrumentet e reja mjedisore është thelbësor për rritjen graduale të pjesëmarrjes.

Ky proces plotësohet nga monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit të ligjit dhe përmirësimi i proceseve në bazë të rezultateve të arritura, duke mundësuar një qasje fleksibile dhe të përshtatshme ndaj sfidave që mund të shfaqen.

Masat që do të ndërmerren:

Zbatimi i projektligjit do të shoqërohet me ndërmarrjen e masave institucionale, ligjore, administrative dhe financiare, si më poshtë:

- Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore të nevojshme për zbatimin e ligjit, veçanërisht për administrimin dhe funksionimin e Fondit Kombëtar të Mjedisit, restaurimin e natyrës dhe certifikimin e largimit të karbonit.
- Ngritja, organizimi dhe funksionalizimi i strukturave përgjegjëse për administrimin e fondit, si dhe për vlerësimin, përzgjedhjen, monitorimin dhe vlerësimin e projekteve që financohen prej tij.
- Përcaktimi i kriterëve, procedurave dhe mekanizmave për aplikimin, financimin, monitorimin, raportimin dhe verifikimin e rezultateve të projekteve të mbështetura.
- Krijimi i procedurave dhe sistemeve për monitorimin e zbatimit të projekteve, matjen e performancës dhe raportimin e rezultateve të arritura.
- Sigurimi i burimeve financiare për funksionimin e Fondit Kombëtar të Mjedisit nëpërmjet buxhetit të shtetit, donacioneve, granteve dhe burimeve të tjera të ligjshme financiare.
- Forcimi i kapaciteteve administrative, teknike dhe profesionale të institucioneve përgjegjëse për zbatimin e ligjit, përmes trajnimeve dhe asistencës teknike.
- Koordinimi ndërinstitutional ndërmjet institucioneve përgjegjëse për mjedisin, financat, zhvillimin rural, klimën dhe sektorët e tjerë përkatës, për të siguruar zbatim efektiv dhe të harmonizuar të dispozitave të ligjit.
- Informimi dhe ndërgjegjësimi i publikut, subjekteve përfituese dhe palëve të interesuara mbi mundësitë e financimit, procedurat e aplikimit dhe detyrimet që rrjedhin nga ligji.

Për të adresuar informacionin mbi risitë e ligjit, nga ana e MM do të informohen subjektet e interesuara, përfshirë bashkitë, organizatat jofitimprurëse, bizneset dhe institucionet akademike, me qëllim rritjen e ndërgjegjësit, pjesëmarrjes dhe aksesit në mekanizmat e rinj të mbështetjes financiare dhe mjedisore.

Kërkesat për përputhshmëri dhe zbatim

Zbatimi efektiv i këtij ligji kërkon një përputhshmëri të plotë me kuadrin ekzistues ligjor, veçanërisht në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe të menaxhimit të financave publike. Në këtë drejtim, është e rëndësishme që ndërhyrja të integrohet në mënyrë koherente me legjislacionin në fuqi, duke shmangur mbivendosjet dhe duke garantuar siguri juridike në zbatim.

Një element kyç i këtij procesi është miratimi dhe zbatimi i plotë i akteve nënligjore për rregullat për certifikimin e largimit të karbonit dhe mekanizmat për mbështetjen e aktiviteteve që kontribuojnë në largimin dhe ruajtjen afatgjatë të karbonit, të cilat konkretizojnë dispozitat e ligjit dhe përcaktojnë procedurat e detajuara për funksionimin e mekanizmave të rinj. Pa këto akte, zbatimi i ligjit mbetet i paplotë, prandaj rëndësia e tyre është thelbësore për funksionalitetin e sistemit.

Gjithashtu, zbatimi i ligjit duhet të shoqërohet me respektimin e parimeve të transparencës, llogaridhënies dhe mirëqeverisjes në shpërndarjen dhe përdorimin e fondeve publike. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në kontekstin e krijimit të Fondit Kombëtar të Mjedisit, ku kërkohet një administrim i rregullt dhe i kontrollueshëm i burimeve financiare.

Në të njëjtën kohë, ndërhyrja është në përputhje me zhvillimet më të fundit të politikave evropiane në fushën e mjedisit dhe klimës. Megjithatë projektligji nuk përbën një nismë formale përafrimi me *acquis* të Bashkimit Evropian, ai kontribuon në modernizimin e kuadrit kombëtar dhe mbështet objektivat e procesit të integritetit evropian në fushën e mjedisit.

Në tërësi, këto kërkesa për përputhshmëri dhe zbatim sigurojnë që ndërhyrja ligjore të mos mbetet vetëm në nivel normativ, por të prodhojë rezultate konkrete dhe të qëndrueshme në përmirësimin e politikave mjedisore.

Faza e shqyrtimit/vlerësimit

- *Jepni një përshkrim të përmblendhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre.*

Monitorimi i zbatimit të ligjit do të koordinohet nga ministria përgjegjëse për mjedisin, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, strukturat administruese të Fondit Kombëtar të Mjedisit dhe përfituesit e financimit. Këto institucione do të raportojnë periodikisht mbi përdorimin e fondeve, ecurinë e projekteve të financuara, rezultatet mjedisore të arritura dhe funksionimin e mekanizmave të rinj të parashikuar nga ligji. Raportimi do të shërbejë për vlerësimin e efektivitetit të ndërhyrjes, transparencës në administrimin e fondeve dhe arritjen e objektivave të politikës mjedisore.

Ndër treguesit kryesorë për të matur progresin dhe arritjen e objektivave të ligjit mund të përfshihen:

- numri i projekteve të financuara nga Fondi Kombëtar i Mjedisit,
- vlera totale e fondeve të alokuara dhe të disbursuara çdo vit, në raport me fondin e miratuar;
- numri i përfituesve të mbështetur, përfshirë bashkitë, organizatat jofitimprurëse, bizneset, institucionet akademike dhe komunitetet lokale;
- përqindja e projekteve të përfunduara brenda afateve dhe buxheteve të miratuara;
- numri i projekteve që kontribuojnë drejtpërdrejt në objektivat kombëtare të mbrojtjes së mjedisit, restaurimit të natyrës, biodiversitetit dhe veprimit klimatik;
- numri i projekteve që mbështesin përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i përafrimit me legjislacionin e Bashkimit Evropian;
- numrin e akteve nënligjore të miratuara për funksionimin e Fondit;

- shkalla e përmbushjes së detyrimeve të monitorimit dhe raportimit nga përfituesit e fondeve;
- numri i aktiviteteve informuese dhe trajnuese të zhvilluara për institucionet dhe subjektet përfituese.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

Shifrat në tabelë janë të shprehura në mijë (000) Lekë.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a

Shifrat në tabelë janë të shprehura në mijë (000) Lekë.

[illegible]

Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total	-
---	---

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në mijë lekë		Vlera aktuale neto në mijë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1	812,367	812,367	0
Opsioni 2	0	0	0

Përfitimet financiare të drejtpërdrejta priten të realizohen nga subjektet përfituese të projekteve dhe veprimtarive në fushën e mjedisit, të cilat do të financohen nga Fondi Kombëtar i Mjedisit. Për qëllime të analizës financiare, këto përfitime janë konsideruar të barabarta me fondet e transferuara tek përfituesit, ndërsa përfitimet mjedisore, sociale dhe ekonomike afatgjata nuk janë monetizuar për shkak të mungesës së të dhënave të mjaftueshme.

Zbatimi i projektligjit nuk parashikon krijimin e strukturave të reja administrative apo shtim të burimeve njerëzore. Funkcionet e administrimit të Fondit Kombëtar të Mjedisit dhe vlerësimit të projekteve do të realizohen nga strukturat ekzistuese të ministrisë përgjegjëse për mjedisin. Për rrjedhojë, nuk parashikohen kosto administrative shtesë për buxhetin e shtetit.